

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
		Faqe	Faqe 1 prej 13
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Versioni	1.0

**APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE NË VITIN 2026 PËR
FURNIZUESIN ME SHËRBIM UNIVERSAL**

Janar, 2026

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
		Faqe	Faqe 2 prej 13
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Versioni	1.0

Përmbajtja

1. Hyrje.....	3
2. Bilanci i energjisë elektrike	3
3. Kostot e blerjes se energjisë me shumicë	6
4. Kostot me pakicë	8
5. Kostot e bartshme	9
6. Përshtatjet dhe Faktori korrigjues i të hyrave	10
7. Të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2026	13

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
		Faqe	Faqe 3 prej 13
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Versioni	1.0

1. Hyrje

Në përputhje me Shtojcën 3 të Rregullës për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU) dhe shkresës zyrtare të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të datës 15 dhjetor 2025, KESCO i ngarkuar me Obligim të shërbimit publik për ofrimin e Furnizimit me energji elektrike si Shërbim Universal, ka përgatitur aplikimin për të hyrat e lejuara maksimale (MAR) për vitin 2026.

Në këtë aplikim janë paraqitur të dhënat e nevojshme për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale, përfshirë kostot e blerjes me shumicë, kostot me pakicë, kostot e bartshme dhe përshtatjet për vitet e mëparshme. Gjatë përgatitjes së aplikimit janë përdorur vlerat e parametrave sipas vendimit të ZRRE-së nr. V_2637_2025, të datës 27 janar 2025.

Duke qenë se procesi tarifar zhvillohet në mënyrë interaktive ndërmjet ZRRE-së dhe të licencuarve të tjerë, ky aplikim mund t'i nënshtrohet ndryshimeve të mëtejshme, me qëllim të reflektimit të kostove të ndërlidhura me të licencuarit e tjerë.

Kapitujt vijues japin shpjegimet dhe arsyetimet e nevojshme për të gjitha kostot e kërkuara, të cilat janë të domosdoshme për operimin e duhur të Furnizuesit me Shërbim Universal.

2. Bilanci i energjisë elektrike

Furnizuesi me Shërbim Universal, në përputhje me obligimet që rrjedhin nga Ligji për Energjinë Elektrike dhe rregullat në fuqi të ZRRE-së, përgatit projeksionet e konsumit për konsumatorët e tij për vitin vijues, duke u bazuar në të dhënat historike të konsumit, trendët e kërkesës, faktorët makroekonomike dhe zhvillimet strukturore në tregun e energjisë elektrike. Këto projeksione shërbejnë si bazë për vlerësimin e nevojave për furnizim me energji elektrike dhe për përcaktimin e kostove të arsyeshme që i nënshtrohen vlerësimit dhe aprovimit rregullativ.

Në periudhën e fundit, tregu vendor është karakterizuar nga ndryshime të rëndësishme, përfshirë edhe zbatimin gradual të liberalizimit të tregut dhe procesin e verifikimit të konsumatorëve që përmbushin kriteret për furnizim në shërbim universal. Ky proces ka qenë kompleks për shkak të natyrës së kriterëve ligjore dhe nevojës për verifikim të vazhdueshëm gjatë vitit tarifar.

Në të njëjtën kohë, konsumi i konsumatorëve që vazhdojnë të përmbushin kriteret për furnizim me shërbim universal ka shënuar rritje. Kjo ka rezultuar në rritje të nevojave për blerje të energjisë elektrike për mbulimin e konsumit të FSHU-së, në përputhje me obligimin ligjor për sigurimin e furnizimit të vazhdueshëm dhe të sigurt për këta konsumatorë.

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
		Faqe	Faqe 4 prej 13
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Versioni	1.0

Të gjitha këto zhvillime janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së projeksioneve dhe korrigjimeve përkatëse të bilancit energjetik për vitin 2026. Megjithatë, marrë parasysh se bilanci energjetik për vitin 2026 nuk është i aprovuar, në këtë aplikim FSHU do të përdor të dhënat sipas draft bilancit të dërguar për aprovim, ku konsumi i parashikuara për FSHU-në për vitin 2026 është 4,665 GWh, siç është paraqitur në tabelën më poshtë:

Niveli i tensionit	GWh
Konsumatorë e kyçur në nivel të tensionit 35 kV	23
Konsumatorë e kyçur në nivel të tensionit 10 kV	210
Konsumatorët komercial 0.4 kV	281
Konsumatorët komercial 0.4 kV / II	752
Konsumatorët e amvisërisë	3,356
Ndriçimi Publik	43
Total konsumi në nivel të shpërndarjes	4,665

Sigurimi i energjisë elektrike për konsumatorët e shërbimit universal realizohet kryesisht përmes prodhimit vendor, burimeve të ripërtëritshme të energjisë, si dhe importit kur prodhimi vendor nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar kërkesën. Importi përdoret si mekanizëm i domosdoshëm për të mbuluar mungesën e energjisë në sistem, veçanërisht gjatë sezonit dimëror dhe në raste të ndërprerjeve të njësive gjeneruese. Prandaj, të dhënat e prezantuara në bilancin e energjisë elektrike, paraqesin elemente kyçe për përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal.

Gjatë vitit 2025, parashikimi i prodhimit vendor të energjisë elektrike nga KEK Gjenerimi në Bilancin energjetik ka qenë më i ulët krahasuar me vitet paraprake, si rezultat i zbatimit të projektit të remontit të njësive gjeneruese Kosova B2, duke rritur nevojën për import të energjisë elektrike për furnizimet me shërbim universal. Ngjashëm, sipas draft bilancit të energjisë elektrike për vitin 2026, KEK gjenerimi ka paraparë vazhdimin e projekteve të rehabilitimit të njësive gjeneruese, këtë herë në njësinë Kosova B1, me një kohëzgjatje të planifikuar prej rreth 8 muajsh, krahasuar me 5 muajt e vitit 2025 për njësinë B2. Kjo situatë pritet të kufizojë edhe më tej disponueshmërinë e prodhimit vendor gjatë vitit 2026, duke rritur në mënyrë të pashmangshme varësinë nga importi i energjisë elektrike.

Në këtë kontekst, duke marrë parasysh edhe trendin e rritjes së konsumit, FSHU, në përputhje me obligimet ligjore për sigurimin e furnizimit të vazhdueshëm, të sigurt dhe të besueshëm të energjisë elektrike, si dhe në harmoni me parimin e njohjes së kostove të arsyeshme dhe të justifikuara sipas kornizës rregullative në fuqi, ka paraparë blerjet e energjisë elektrike bazuar në parashikimin e konsumit dhe kapaciteteve të disponueshme orë për orë të prodhimit vendor, si në tabelën e mëposhtme:

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 5 prej 13
		Versioni	1.0

Bilanci Energjetik 2026	GWh
Blerjet	4,665
<i>KEK Gjenerimi</i>	3,734
<i>Blerjet nga BRE në marrëdhënie kontraktuale me KOSTT</i>	495
<i>Blerjet nga BRE në marrëdhënie kontraktuale me FSHU</i>	13
<i>Importi</i>	422
Konsumi	4,665

Megjithatë, në kushtet reale të operimit të sistemit energjetik të Kosovës, realizimi i plotë dhe i qëndrueshëm i prodhimit vendor sipas planeve vjetore nuk përbën një premisë të garantuar. Në mungesë të realizimit të prodhimit vendor sipas planit orë për orë, sistemi nuk ofron alternativa të brendshme për kompensim, dhe çdo mungesë zëvendësohet në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes importit të energjisë elektrike. Ky mekanizëm është veçanërisht i theksuar gjatë sezonit dimëror, kur në nivel sistemi një pjesë e konsiderueshme e konsumit mbulohet nga burime të jashtme. Si pasojë, çdo devijim nga prodhimi vendor i parashikuar ka efekt të menjëhershëm dhe të pashmangshëm në rritjen e ekspozimit ndaj tregut të importit.

Sigurimi i energjisë elektrike përmes importit zhvillohet në një mjedis të karakterizuar nga kufizime fizike të rrjetit transmetues, konkurrencë rajonale për burime të njëjta dhe nevojë për ndërhyrje në afate shumë të shkurtra kohore. Në këto rrethana, Furnizuesi me Shërbim Universal nuk ka hapësirë për optimizim komercial, por vepron në kushte detyrimi ligjor për të garantuar furnizim të pandërprerë, pavarësisht kushteve të tregut ose kostos që kërkohet për sigurimin e energjisë.

Megjithatë, bartja sistematike e këtij rreziku në nivel të furnizuesit krijon një mospërputhje thelbësore ndërmjet kompetencave, përgjegjësi dhe trajtimit rregullativ të kostove. Prandaj, gjatë vlerësimit të bilancit energjetik dhe të kostove të furnizimit për vitin 2026, është e domosdoshme që supozimet mbi prodhimin vendor të trajtohen me një qasje konservative dhe të matur, duke reflektuar rrezikun real të devijimeve dhe ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë në nevojën për import, e cila bazohen në të dhënat historike të prodhimit, respektivisht importit në baza orare.

Një qasje e tillë siguron një pasqyrim real të kostove të nevojshme për garantimin e furnizimit të pandërprerë në kushtet në të cilat operon sistemi, ndërsa mos reflektimi i këtij rreziku në procesin tarifar krijon një pritshmëri jorealiste që Furnizuesi me Shërbim Universal të sigurojë furnizim të pandërprerë mbi bazën e supozimeve që nuk realizohen në praktikë, duke transferuar në mënyrë të heshtur dhe të vazhdueshme koston e këtij hendeku nga viti në vit. Një qasje e tillë nuk është në përputhje me parimet rregullative të kostos reale, të proporcionalitetit dhe të ndarjes së drejtë të rrezikut ndërmjet aktorëve të tregut.

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 6 prej 13
		Versioni	1.0

3. Kostot e blerjes se energjisë me shumicë

Kostot e blerjes së energjisë me shumicë përbëjnë komponentin kryesor të kostos totale për shërbimin universal dhe lidhen drejtpërdrejt me nevojën për sigurimin e energjisë elektrike në sasi të mjaftueshme për të mbuluar konsumin e parashikuar.

Struktura e blerjeve të energjisë elektrike është ndërtuar në përputhje me parimet rregullative të kostos reale të pritshme, duke marrë parasysh kufizimet strukturore të sistemit, varësinë nga prodhimi vendor dhe nevojën për sigurimin e sasive plotësuese përmes tregut, në rastet kur furnizimi vendor nuk mjafton për të mbuluar kërkesën.

Me qëllim të kalkulimit të kostove për blerjet e energjisë elektrike për mbulimin e nevojave të konsumit, FSHU në këtë aplikim ka përdorur çmimin e pandryshuar për Gjenerimin vendor dhe BRE-të. Sidoqoftë, duhet të theksohet se çdo ndryshim në çmimin e BRE-ve duhet të pasqyrohet nga ZRRE në procesin e llogaritjes së të hyrave të lejuara maksimale të FSHU-së.

Ndryshe nga prodhimi vendor, energjia elektrike e siguruar përmes importit paraqet komponentin më të ndjeshëm të strukturës së kostove të furnizimit, për shkak të ekspozimit të drejtpërdrejtë ndaj kushteve të tregut dhe diferencës së theksuar në çmim krahasuar me prodhimin vendor. Vetëm në procesin tarifor për vitin 2025, importi ishte parashikuar të mbulonte rreth 5% të energjisë së nevojshme, megjithatë, si rezultat i rritjes së konsumit dhe mospërputhjeve të përsëritura në realizimin e prodhimit vendor, sasia reale e energjisë së siguruar përmes importit është dyfishuar krahasuar me parashikimin fillestar. Për shkak se energjia e siguruar përmes importit nga aspekti i kostove nuk është proporcionalisht me gjenerimin vendor, rritja e kostos së importit tejkaloi vlerat e lejuara gjatë shqyrtimit tariforë prej afërsisht 36 milion euro.

Sipas bilancit energjetik për vitin 2026, importi përbën rreth 9% të energjisë së nevojshme për mbulimin e kërkesës së FSHU-së. Prandaj, për vitin 2026 kërkohet që vlerësimi rregullativ i kostove të furnizimit të trajtojë komponentin e importit në mënyrë realiste dhe në përputhje me kushtet e tregut, me qëllim që të sigurohet mbulim i kostove të domosdoshme për furnizim të pandërprerë.

Kushtet e fundit të tregut kanë treguar rëndësinë e rritjes së sigurisë së furnizimit dhe menaxhimit të rrezikut në sigurimin e energjisë elektrike, veçanërisht për periudhat kur sistemi vendor përballet me mungesë të prodhimit.

Për këtë arsye, FSHU në dhjetor të vitit 2025, pas diskutimeve dhe aprovimit në parim nga ZRRE për kostot e sigurimit të kapaciteteve vjetore, ka marrë pjesë në ankandet vjetore për blerjen e kapaciteteve ndërkufitare, në përputhje me rregullat e tregut dhe mundësitë e disponueshme. Sigurimi i këtyre kapaciteteve përfaqëson një mekanizëm që mund të zvogëlojë ekspozimin ndaj

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
		Faqe	Faqe 7 prej 13
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Versioni	1.0

çmimeve të larta në tregjet afatshkurtra dhe të lehtësojë sigurimin e energjisë në periudha kritike. Për këtë arsye, këto kosto duhet të përfshihen në tarifa si pjesë përbërëse e kostove të lejueshme të Furnizuesit me Shërbim Universal.

Megjithatë, është e rëndësishme të sqarohet se shfrytëzimi i plotë i kapaciteteve ndërkufitare varet edhe nga faktorë të jashtëm, përfshirë disponueshmërinë reale të rrugëve të transmetimit dhe kufizimet teknike. Përkundër këtyre kufizimeve, qasja e ndërmarrë synon të kontribuojë në stabilitetin e furnizimit dhe në menaxhimin më të mirë të rrezikut të tregut

Për rrjedhojë, gjatë vlerësimit të kostove të blerjeve për vitin 2026, është thelbësore që komponenti i importit të trajtohet me një qasje realiste, në përputhje me draft bilancin energjetik dhe me përvojën e realizuar, në mënyrë që të sigurohet një reflektim i drejtë i kostove të domosdoshme për furnizim dhe të shmanget bartja e përsëritur e hendekëve financiarë nga viti në vit mbi Furnizuesin me Shërbim Universal.

Bazuar në të lartë-thënat dhe konform Rregullës për të Hyrat e FSHU-së, kostot totale për mbulimin e konsumit të parashikuar për vitin 2026 janë vlerësuar si 229.04 milion €.

Përshkrimi	GWh	mil€
KEK Gjenerimi në %	80.0%	48.1%
Importi në %	9.0%	29.1%
Prodhimi nga BRE-të vendore në %	10.9%	14.5%
Komponentët Financiare në %		8.4%
Kostot e Blerjes së Energjisë me Shumicë	4,665.00	229.04

Bazuar në të lartë-thënat dhe konform Rregullës për të Hyrat e FSHU-së, kostot totale për mbulimin e konsumit të parashikuar për vitin 2026 janë vlerësuar si 229.04 milion €.

FSHU rithekson se ZRRE gjatë vlerësimit të kostove të blerjeve për vitin 2026, duhet të trajtojë kërkesën me një qasje realiste, në përputhje me draft bilancin energjetik dhe me përvojën e realizuar, në mënyrë që të sigurohet një reflektim i drejtë i kostove të domosdoshme për furnizim të pandërprerë të energjisë elektrike.

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 8 prej 13
		Versioni	1.0

4. Kostot me pakicë

Përveç kostove të furnizimit me energji elektrike, FSHU ka edhe obligime operative për të siguruar shërbime të rregullta dhe funksionale për konsumatorët, përfshirë proceset e faturimit, informimit, kujdesit ndaj konsumatorëve, zbatimit të kërkesave ligjore dhe përputhshmërisë me standardet e shërbimit.

Në vitet e fundit, presioni operacional është rritur si rezultat i rritjes së numrit të konsumatorëve dhe volumit të shërbimeve, kërkesave të reja rregullative dhe teknike, nevojës për përmirësim të sistemeve të punës dhe saktësisë së të dhënave dhe rritjes së përgjithshme të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve në treg (inflacioni). Rritja e këtyre shpenzimeve nuk përfaqëson zgjerim diskrecional të aktivitetit, por një proces të domosdoshëm për përmbushjen e obligimeve ligjore, garantimin e informimit korrekt të konsumatorëve dhe sigurimin e vazhdimësisë së furnizimit universal.

Numri i konsumatorëve të furnizuar nga FSHU vazhdon të rritet, me një trend vjetor prej rreth 4%. Kjo rritje reflektohet drejtpërdrejt në volumin e shërbimeve të ofruara dhe në kostot e ofrimit të shërbimeve, të cilat rrisin zgjerimin e bazës së konsumatorëve, kompleksitetin e proceseve dhe kërkesat për shërbim të vazhdueshëm dhe cilësor. Prandaj, FSHU ka qenë e detyruar të përshtatë proceset e brendshme dhe të investojë në përmirësimin e shërbimeve brenda buxhetit të lejuar të ZRRE-së.

Megjithëkëtë, nga marsi i vitit 2025, në zbatim të kërkesave të ZRrE-së lidhur me liberalizimin e tregut për konsumatorët komercialë të kyçur në nivel të shpërndarjes, FSHU ka qenë e detyruar të angazhojë burime shtesë njerëzore për realizimin e proceseve intensive të informimit, për mbi 100 mijë konsumatorë komercial. Si pasojë, është rritur ndjeshëm puna jashtë orarit zyrtar dhe kostot shtesë përcjellëse, përfshirë por pa u kufizuar në shpenzime për komunikim publik, përmes telefonisë dhe marrëdhënies me publikun (PR), si dhe shpenzime logjistike, përmes materiale informuese dhe shpërndarje. Ky proces ka rritur ndjeshëm shpenzimet operative duke tejkaluar vlerat e lejuara.

Duke qenë se këto kosto shtesë janë drejtpërdrejt të lidhura me zbatimin e procesit të liberalizimit sipas kërkesës së ZRRE-së dhe nuk lidhen me zgjerim vullnetar të aktivitetit ose investime të brendshme të planifikuara, përkatësisht të njëjtat nuk do të kishin lindur në mungesë të këtij detyrimi rregullativ, në vlerësojmë se është e rëndësishme që shpenzimet operative të krijuara gjatë vitit 2025 të njihen dhe të reflektohen si të arsyeshme në analizat tarifore dhe vendimmarrjen rregullative, ashtu siç janë paraqitur në të dhënat aktuale. Për më tepër, më 11 qershor 2025, FSHU ka dërguar një shkresë zyrtare në ZRRE për të informuar lidhur me kostot shtesë dhe njëkohësisht duke kërkuar njohjen e tyre në tarifa si kosto të arsyeshme dhe jashtë kontrollit të FSHU, për të cilat nuk është pranuar ndonjë kundërshtim. Për transparencë FSHU në aplikimin tarifor ka zbritur tashmë shpenzimet operative të ndërlidhura me funksionin e furnizuesit në shërbimin e tregut të hapur nga totali i shpenzimeve operative.

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 9 prej 13
		Versioni	1.0

Në vlerësimin e shpenzimeve operative është e rëndësishme të merret parasysh se gjatë viteve të fundit vlera reale e parasë është dobësuar ndjeshëm si pasojë e inflacionit dhe rritjes së përgjithshme të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve në vend. Niveli aktual i shpenzimeve operative të lejuara nuk reflekton plotësisht këto zhvillime ekonomike dhe fuqinë reale blerëse në Kosovë, duke krijuar mospërputhje ndërmjet të hyrave të aprovuara dhe kostove reale të domosdoshme për funksionim të qëndrueshëm të shërbimit universal.

Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për rritjen e pagës minimale në 425 euro nga janari 2026 dhe në 500 euro nga korriku 2026, pritet një efekt zinxhiror në kostot operative të Furnizuesit me Shërbim Universal. Ky vendim, i cili është i detyrueshëm dhe jashtë kontrollit të FSHU-së, do të ndikojë drejtpërdrejt në çmimet e shërbimeve esenciale të ofruara nga kompanitë partnere dhe nën-kontraktorët, si sigurimi fizik, pastrimi, mirëmbajtja dhe shërbimet teknike mbështetëse, të cilat janë të domosdoshme për funksionimin e kompanisë.

Në të njëjtën kohë, zhvillimet në tregun e punës krijojnë presion edhe në strukturën e brendshme të kompanisë. Sipas të dhënave zyrtare, paga mesatare neto në sektorin e energjisë është rreth 20% më e lartë se paga mesatare aktuale në FSHU, duke krijuar sfida në motivimin, ruajtjen e stafit profesional dhe konkurrueshmërinë e brendshme. Ngushtimi i diferencës ndërmjet pagës minimale dhe pagave profesionale rrit nevojën për rishikim të strukturës së pagave, me qëllim ruajtjen e stabilitetit të stafit dhe cilësisë së shërbimit. Punonjësit e Furnizuesit me Shërbim Universal janë qytetarë të këtij vendi dhe përbëjnë një element kyç në garantimin e furnizimit të sigurt dhe të vazhdueshëm me energji elektrike. Mos-reflektimi i inflacionit vendor dhe i zhvillimeve reale ekonomike në shpenzimet operative të lejuara rrezikon të vështirësojë operimin e qëndrueshëm dhe përmbushjen e standardeve të nevojshme të cilësisë dhe sigurisë së shërbimit në vitet në vijim.

Kompania jonë mbetet e angazhuar në përmbushjen e detyrimeve të saj, por adresimi i këtyre kostove është thelbësor për të siguruar që operimi të mbetet i qëndrueshëm dhe në përputhje me standardet e kërkuara nga rregullatori.

5. Kostot e bartshme

Në përputhje me kornizën rregullative, një pjesë e rëndësishme e kostos totale të shërbimit universal përbëhet nga kostot e bartshme, të cilat përfshijnë edhe kostot që lidhen me përdorimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes, si dhe elemente të tjera të përcaktuara nga rregullat në fuqi.

Këto kosto janë të lidhura me operatorët përkatës të sistemit dhe reflektojnë nevojën për mirëmbajtje, stabilitet dhe investime në rrjet, prandaj mbeten një komponent i rëndësishëm në strukturën e përgjithshme të tarifave dhe duhet të trajtohen në mënyrë të përshtatshme gjatë procesit tarifor, në përputhje me vendimet përkatëse të rregullatorit.

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 10 prej 13
		Versioni	1.0

Duke qenë se afatet kohore për përcaktimin përfundimtar të tarifave të OSSH-së dhe OST-së nuk janë të harmonizuara me afatet e aplikimit të FSHU-së për të hyrat e lejuara dhe duke marrë parasysh dinamikat aktuale të tregut dhe pritshmëritë për rritje të kostove të rrjeteve, megjithëse të njëjtat janë subjekt i aprovimit të ZRRE-së, FSHU me qëllim të reflektimit sa më të saktë të kërkesës përfundimtare, ka aplikuar një rritje të pritshme lineare të arsyeshme prej 20% në tarifën e OSSH-së dhe OST-së. Në bazë të aplikimit të këtyre tarifave të supozuara mbi sasinë e pritshme të energjisë së konsumuar, kostot e bartjes dhe shpërndarjes rezultojnë në vlerë prej 227.94 milion euro.

Ky supozim nuk përfaqëson kosto të shkaktuara apo të ndikuara nga Furnizuesi, por është bërë ekskluzivisht për qëllime informuese dhe transparence, me synim që Rregullatori dhe publiku të kenë një pasqyrë të qartë mbi efektin potencial të kostove të rrjeteve (të transmetimit dhe shpërndarjes) në faturën e konsumatorit fundor, në kushtet kur këto tarifa përcaktohen dhe miratohen në një proces të veçantë rregullator. Çdo ndryshim eventual i këtyre tarifave, i miratuar nga ZRRE gjatë procesit tarifor për OSSH-në dhe OST-në, duhet të pasqyrohet në mënyrë të drejte dhe proporcionale në MAR-in përfundimtar të Furnizuesit me Shërbim Universal, në përputhje me parimet e reflektimit të kostove reale dhe neutralitetit rregullativ.

6. Përshtatjet dhe Faktori korrigjues i të hyrave

Në përputhje me kornizën rregullative në fuqi dhe parimet e rregullimit tarifor, faktori korrigjues shërben për të adresuar dallimet ndërmjet kostove të lejuara të përcaktuara në procesin tarifor dhe kostove reale të realizuara gjatë vitit tarifor, në rastet kur këto kosto nuk janë mbuluar nga të hyrat e pranuar.

Në vitin 2025, FSHU është përballur me rritje të ndjeshme të kostove reale, veçanërisht si rezultat i rritjes së konsumit dhe nevojës për import shtesë në periudha kur prodhimi vendor nuk ka qenë i mjaftueshëm. Duke qenë se energjia nga importi zëvendëson drejtpërdrejt mungesën e prodhimit vendor dhe ekspozohet ndaj kushteve të tregut rajonal dhe evropian, rritja e kostove të furnizimit ka qenë e pashmangshme dhe jashtë kontrollit operacional të FSHU-së. Këto zhvillime reflektojnë kushte reale të tregut dhe kufizime strukturore të sistemit, dhe për rrjedhojë përbëjnë bazë të arsyeshme për aplikimin e faktorit korrigjues, me qëllim njohjen e diferencës ndërmjet kostove reale të justifikuara dhe të hyrave të pranuar përmes tarifave.

Për më tepër, zhvillimet në procesin e liberalizimit të tregut kanë krijuar sfida tranzitore, si në aspektin ligjor ashtu edhe atë operativ, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në planifikimin e konsumit dhe në menaxhimin e profileve të furnizimit. Duke qenë se nga aspekti operativ sistemi nuk ka qenë plotësisht i gatshëm për zbatimin e hapjes së tregut brenda një afati kaq të shkurtër me një

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 11 prej 13
		Versioni	1.0

numër kaq të lartë të konsumatorëve, mospërputhjet dhe sfidat e evidentuara gjatë këtij procesi kanë gjeneruar kosto që objektivisht nuk kanë mundur të evitohen.

Një ndër këto ka qenë procesi i identifikimit të konsumatorëve që përmbushin ose jo kriteret për furnizim me shërbim universal, proces i cili është shpjeguar edhe tek pjesa e shpenzimeve operative. Megjithatë, përveç rritjes së kostove operative, procesi është ndikuar nga zhvillime të paparashikuara dhe ndryshime procedurale gjatë vitit. Në veçanti, njoftimi për pezullimin e përkohshëm të liberalizimit për muajin gusht 2025 ka arritur me vonesë dhe me efekt retroaktiv, duke krijuar situata të jobalancit për periudhën përkatëse. Për këtë çështje, FSHU i është drejtuar ZRRE-së edhe përmes shkresave zyrtare të datës 4 gusht 2025, duke argumentuar ndikimin financiar dhe operacional që kjo situatë ka shkaktuar.

Siç është informuar edhe ZRRE, procesi i identifikimit të konsumatorëve në kuadër të liberalizimit të tregut është zhvilluar brenda afateve shumë të shkurta dhe kushteve të veçanta operative, çka ka sjellë nevojën për verifikime shtesë pasuese. Si pasojë, një numër i kufizuar konsumatorësh, të cilët fillimisht ishin larguar nga portofoli i Furnizuesit me Shërbim Universal, pas ankesave dhe rishqyrtimeve janë konfirmuar se gëzojnë të drejtën ligjore për furnizim universal. Meqenëse gjatë periudhës përkatëse këta konsumatorë nuk kanë qenë pjesë e portofolit aktiv, energjia për konsumin e tyre nuk ka qenë e parashikuar paraprakisht, ndërsa pas kthimit në portofolion e FSHU dhe bazuar në të dhënat e matjes nga operatori përkatës, është kryer faturimi korrektues. Këto rregullime, të lidhura drejtpërdrejt me natyrën tranzitore të procesit të liberalizimit, kanë reflektuar diferenca teknike ndërmjet energjisë së planifikuar dhe asaj të realizuar, të cilat janë trajtuar sipas mekanizmave përkatës të sistemit elektroenergjetik, në përputhje me kornizën rregullative në fuqi.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se gjatë periudhës qershor–korrik, një pjesë e këtyre konsumatorëve kanë qenë të furnizuar përmes Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, prandaj çdo korrigjim shtesë që rezulton nga rishikimi i këtij procesi duhet të reflektohet proporcionalisht si kosto e arsyeshme për FSHU-në, në përputhje me parimet e neutralitetit rregullativ dhe mbulimit të kostove të justifikuara.

Përfundimisht theksojmë se duke qenë se nga aspekti operativ sistemi nuk ka qenë plotësisht i gatshëm për zbatimin e hapjes së tregut brenda një afati kaq të shkurtër, mospërputhjet dhe sfidat e evidentuara gjatë këtij procesi kanë gjeneruar kosto që objektivisht nuk kanë mundur të evitohen. Si të tilla, këto kosto përfaqësojnë pasojë të natyrshme të një procesi tranzitor të kërkuar rregullativisht dhe duhet të trajtohen si kosto të arsyeshme në kuptim të kornizës rregullative në fuqi. Mosnjohja e tyre do të krijonte një mospërputhje ndërmjet obligimeve të vendosura dhe trajtimit financiar përkatës, duke rrezikuar koherencën dhe besueshmërinë institucionale të procesit të liberalizimit.

Në pajtim me Rregullën për të Hyrat e FSHU-së është bërë korrigjimi i të hyrave të vitit 2025, respektivisht FSHU ka llogaritur MAR-in aktual dhe të hyrat e realizuara gjatë vitit 2025. Sipas

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
		Faqe	Faqe 12 prej 13
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Versioni	1.0

kalkulimeve faktori korrigjues ka rezultuar të jetë 49.54 milion € e cila është përshtatur në MAR-in e vitit 2026.

Përshkrimi	mil €
MAR-i i Aprovuar	435.93
MAR-i Aktual	489.95
Shitjet aktuale	443.47
I _t	6.91%
Faktori Korrigjues	49.69

Në përputhje me Rregullën për të Hyrat e FSHU, faktori korrigjues ka për qëllim që procesi tarifor të mbetet i drejtë dhe i balancuar, duke mos lejuar që diferencat e krijuara në një vit të bartën në mënyrë të vazhdueshme nga viti në vit pa trajtim adekuat, pasi kjo rrezikon stabilitetin financiar të shërbimit universal dhe rrjedhimisht, sigurinë e furnizimit për konsumatorët. Por, të dhënat tarifore tregojnë se faktori korrigjues për vite mme radhe është duke u bartur nga një vit në tjetrin në vlera të konsiderueshme, që tregon qartë se tarifat e aplikuar nuk kanë reflektuar plotësisht kostot reale të furnizimit me shërbim universal, efekti i të cilave ka sifudar tërë sektorin elektroenergjitë.

Në këtë kontekst, njohja dhe trajtimi korrekt i faktorit korrigjues në këtë aplikim tarifor është thelbësore për të rikthyer balancën financiare, për të shmangur akumulimin e mëtejshëm të diferencave nga viti në vit dhe për të siguruar që FSHU të ketë kapacitetin financiar për të përmbushur obligimin e tij ligjor për furnizim të pandërprerë dhe të sigurt. Përfshirja e këtyre kostove në tarifa është në përputhje me parimet e rregullimit të drejtë, transparencës dhe mbulimit të kostove të arsyeshme, si dhe me objektivin për funksionim të qëndrueshëm të shërbimit universal në interes të konsumatorëve dhe stabilitetit të sektorit.

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 13 prej 13
		Versioni	1.0

7. Të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2026

Pas marrjes në konsideratë të shpenzimeve të pritshme, kërkesa e FSHU-së për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2026 është 528.78 milion €.

Përshkrimi	mil €
Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes	11.14
Blerjet	229.04
Kostot e Bartshme	227.94
Të tjera	11.12
Korrigjimet	49.54
Kërkesa finale	528.78

Kjo kërkesë reflekton nevojën për të mbuluar kostot e domosdoshme për:

- furnizimin e energjisë elektrike për konsumatorët në shërbim universal,
- përballimin e ndikimit të importit si komponent me kosto më të lartë,
- rritjen e sigurisë së furnizimit në periudhat e sezonit dimëror që konsiderohen me rrezik të lartë,
- mbulimin e kostove operative të nevojshme për ofrimin e shërbimeve cilësore,
- mbulimin e kostove të bartshme që lidhen me rrjetin dhe obligimet përkatëse,
- trajtimin e diferencave të krijuara nga rrethanat reale të vitit paraprak, në përputhje me parimet rregulative

FSHU vlerëson se reflektimi real i këtyre kostove në procesin tarifar është i domosdoshëm për të garantuar që shërbimi universal të mbetet funksional, i qëndrueshëm dhe i aftë për të përmbushur obligimet ligjore ndaj konsumatorëve. Nëse këto kosto nuk pasqyrohen në mënyrë adekuate, rrezikohet ndjeshëm furnizimi i qëndrueshëm. Përvoja e viteve të kaluara ka treguar se nënvlerësimi i kostove krijon vështirësi operationale dhe përsëritja e një qasjeje të tillë do të rrezikonte të prodhonte sfida të ngjashme edhe në të ardhmen.

FSHU mbetet e gatshme të bashkëpunojë me ZRRE-në gjatë gjithë procesit tarifar, duke ofruar të gjitha sqarimet, analizat dhe dokumentacionin e nevojshëm për vlerësim të drejtë dhe transparent.